

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të Pavarur

Agjencia e Sigurimit të Depozitave

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur.....	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.....	3
Pasqyra e ndryshimeve në fondet e sigurimit të depozitave.....	4
ISHënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare	5-37

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Këshillin Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave ("Agjencia"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondin e sigurimit të depozitave dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave materiale të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Agjencisë më 31 dhjetor 2024 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Agjencia në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të Tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2024 të Agjencisë

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Agjencisë për vitin 2024, për gatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Agjencisë për vitin 2024 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë opinion mbi to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identikuara më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për për gatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur për gatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në për gatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Agjencisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Agjencisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabël, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionet, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Agjencisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshme rinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Agjencisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Agjencisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilat janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

25 mars 2025

Mediana Shkollari
[Signature]



AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**Pasqyra e pozicionit financiar***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	2,096,063,998	1,404,953,188
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale	9	68,253,878,520	62,318,880,652
Aktive afatgjata materiale, neto	10	58,836,072	57,407,985
Aktive afatgjata jo materiale, neto	11	2,027,125	2,562,100
Aktive të tjera, neto	12	4,427,068	5,822,416
TOTALI I AKTIVEVE		70,415,232,783	63,789,626,341
DEYRIMET			
Detyrime të tjera	13	16,580,902	13,923,794
TOTALI I DETYRIMEVE		16,580,902	13,923,794
FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE			
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	14	400,000,000	400,000,000
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në Shoqëri Kursim Krediti ("SHKK")	14	76,000,000	76,000,000
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka		69,741,779,608	63,152,868,055
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK		180,872,273	146,834,492
TOTALI I FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE		70,398,651,881	63,775,702,547
TOTALI I DETYRIMEVE DHE FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE		70,415,232,783	63,789,626,341

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 5 deri në 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të ardhura operative			
Të ardhura nga primet e sigurimit	15	4,422,317,060	4,193,699,571
Të ardhura nga kontributet fillestare	16	-	-
Të ardhura nga interesat	17	2,843,668,202	2,355,098,483
Të ardhura të tjera operative	18	3,151,927	2,527,926
Totali i të ardhurave operative		7,269,137,189	6,551,325,980
Shpenzime financiare			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(512,960,331)	(659,334,197)
Shpenzime të tjera financiare	19	(6,566,126)	(53,330,176)
Totali i shpenzimeve financiare		(519,526,457)	(712,664,373)
Shpenzime operative			
Shpenzime personeli	20	(89,638,794)	(85,145,313)
Shpenzime administrative	21	(27,173,684)	(29,840,830)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11	(8,819,991)	(7,594,865)
Totali i shpenzimeve operative		(125,668,468)	(122,581,008)
Shpenzime provigjionit të instrumentave financiare për të mbledhur flukse kontraktuale Rimarrje/(Shpenzime) provigjioni të instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale, neto	8, 9	(3,991,848)	-
		2,962,918	1,967,558
TEJKALIMI I TË ARDHURAVE NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN		6,622,949,333	5,718,048,157
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE		6,622,949,333	5,718,048,157

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 5 deri në 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin		6,622,949,333	5,718,048,157
Regullime për:			
Të ardhura nga interesat	17	(2,843,668,202)	(2,355,098,483)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11	8,819,991	7,594,865
Lëvizja në fondin e provigjonit për instrumentet financiare	9	(2,952,774)	(1,956,877)
Ndryshimet në:			
Aktive të tjera		1,395,348	22,142,280
Detyrime të tjera		2,656,108	(8,889,990)
Interesi i arkëtuar		2,712,747,607	2,173,201,770
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ		6,501,948,113	5,555,041,722
AKTIVITETI INVESTUES			
Blerje e aktiveve afatgjata	11	(9,712,904)	(4,116,014)
Shtesat e instrumenteve financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale		(5,801,124,498)	(6,128,942,059)
Blerë gjatë vitit		(33,762,830,000)	(29,094,540,000)
Maturuar gjatë vitit		27,961,705,502	22,965,597,941
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues		(5,810,837,403)	(6,133,058,073)
Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit		691,110,710	(578,016,351)
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	8	1,404,953,188	1,982,969,539
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	8	2,096,063,998	1,404,953,188

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 5 deri në 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Pasqyra e ndryshimeve në fondet e sigurimit të depozitave
(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

	Fondi themeltar		Fondi i akumuluar për		Totali
	Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK	
Më 1 janar 2023	400,000,000	76,000,000	57,465,285,509	116,368,881	58,057,654,390
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	-	-	5,687,582,546	30,465,611	5,718,048,157
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	5,687,582,546	30,465,611	5,718,048,157
Më 31 dhjetor 2023	400,000,000	76,000,000	63,152,868,055	146,834,492	63,775,702,547
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	-	-	6,588,911,553	34,037,780	6,622,949,333
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	69,741,779,608	180,872,273	70,398,651,881
Më 31 dhjetor 2024	400,000,000	76,000,000	69,741,779,608	180,872,273	70,398,651,881

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 5 deri në 37 janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

Pasqyrat financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë me Vendim Nr. 5, datë 25 mars 2025, dhe nënshkruar në emër të Agjencisë nga:



z. Genci Mamani
Drejtori i Përgjithshëm

znj. Ornela Shqarri
Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Investimeve



1. Informacion i përgjithshëm mbi entitetin raportues

Agjencia e Sigurimit të Depozitave ("Agjencia" ose "ASD") është një institucion publik i pavarur, i themeluar në vitin 2002 dhe ushtrimi i veprimtarisë së tij rregullohet nga ligji nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar ("Ligji"). Në përputhje me Ligjin, Agjencia i raporton Bankës së Shqipërisë ("Autoriteti Mbikëqyrës"), Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. ASD-ja është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave ("IADI") dhe e Forumit Evropian të Siguruesve të Depozitave ("EFDI"). Agjencia është themeluar me qëllim sigurimin dhe kompensimin e depozitave të individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare në bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit ("SHKK - të") që operojnë në Shqipëri. Subjektet, të cilat janë anëtare të skemës së sigurimit, nuk mund të pranojnë depozita nëse nuk janë të siguruara nga ASD-ja. Kompensimi i depozitave të siguruara fillon kur Agjencia njoftohet me shkrim nga Banka e Shqipërisë mbi ndërhyrjen në një subjekt anëtar të skemës.

Agjencia e nisi veprimtarinë e saj më 12 tetor 2002. Agjencia ushtron funksionet e saj, me qëllim përbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit. Në veçanti, por jo vetëm, Agjencia anëtarëson dhe përjashton subjektet në skemë; verifikon të dhënat e raportuara periodikisht nga subjektet anëtare; kryen inspektime të plota dhe të pjesshme në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave në subjektet anëtare; zhvillon veprimtari për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për skemën e sigurimit të depozitave; kompenson depozitat, sipas dispozitave të këtij ligji; arkëton kontributet fillestare, primet e sigurimit, dhe kontributet e jashtëzakonshme; dhe investon mjetet financiare, sipas dispozitave të këtij ligji.

Bazuar në Ligj, Agjencia siguron deri në 2,500,000 Lek depozitat e individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare në çdo subjekt anëtar të skemës së sigurimit. Më 31 dhjetor 2024 bankat që operonin në Shqipëri ishin 11 banka (2023:11 banka).

Agjencia, në përputhje me Ligjin, siguron deri në 2,000,000 Lek depozitat e individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare në çdo shoqëri kursim-krediti që është anëtare e skemës së sigurimit. Aktualisht, në skemën e sigurimit të depozitave janë përfshirë 9 shoqëri kursim krediti.

Duke filluar nga data 1 Janar 2018, në zbatim të ligjit 133/2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë, Agjencia e Sigurimit të Depozitave administron Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në përputhje me parashikimet e këtij Ligji dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara për këtë qëllim nga Banka e Shqipërisë. Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, i cili përbëhet nga kontributet e vetë bankave do të përdoret për të mundësuar zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të parashikuara në ligjin 133/2016 " Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë".

Aktualisht adresa dhe zyrat qendrore të Agjencisë janë në Tiranë ("Ruga e Elbasanit", Tiranë, Shqipëri). Më 31 dhjetor 2024 Agjencia kishte 27 punonjës (31 dhjetor 2023: 26).

2. Kuadri rregullator i veprimtarisë së ASD-së

Veprimtaria e ASD-së rregullohet nga ligji për sigurimin e depozitave dhe aktet nënligjore përkatëse të nxjerra nga Agjencia dhe Autoriteti Mbikëqyrës. Ligji dhe aktet nënligjore kërkojnë që të ardhurat e mbledhura nga institucionet anëtare të skemës së sigurimit duhet të investohen në tituj borxhi të emetuar nga Qeveria e Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë, tituj borxhi të emetuar nga qeveri ose banka qendrore të huaja të vlerësuara si të sigurta nga agjenci të njohura të vlerësimit të kreditit, ose të vendosen në depozita afatshkurta në Bankën e Shqipërisë ose në institucione financiare ndërkombëtare të vlerësuara si të sigurta nga agjenci të njohura të vlerësimit të kreditit.

Më 31 dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, të gjitha investimet kanë një afat maturimi jo më të gjatë se pesëmbëdhjetë vjet nga data e blerjes së tyre nga Agjencia.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

2. Kuadri rregulator i veprimtarisë së ASD-së (vazhdim)

Organi më i lartë drejtues i Agjencisë është Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Autoriteti Mbikëqyrës. Dy anëtarë propozohen nga Autoriteti Mbikëqyrës, dy anëtarë propozohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe një anëtar propozohet nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë jo ekzekutiv, me përjashtim të anëtarit që emërohet në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm. Ligji për sigurimin e depozitave përcakton se afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Drejtues është pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje, bazuar në treguesit e performancës të veprimtarisë së tyre.

Këshilli Drejtues më 31 dhjetor 2024 përbëhet nga:

Z.	Donald Duraj	Kryetar i Këshillit Drejtues (KD)
Z.	Genci Mamani	Anëtar
Znj.	Adelina Xhemali	Anëtar
Z.	Shkëlzen Margjeka	Anëtar
Znj.	Vasilika Vjero	Anëtar

3. Bazat e përgatitjes dhe zbatimit të SNRF-të

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"-të) të publikuara nga Bordi.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare.

(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Agjencisë.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën, në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme të ndikuara. Informacione rreth çështjeve të rëndësishme të pasigurisë në vlerësime dhe gjykimeve kritike për zbatimin e politikave kontabël, që kanë efektin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë përfshirë në Shënimet 6 dhe 7.

(e) Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Agjencisë janë përgatitur në përputhje me supozimin e vijimësisë, i cili supozon se Agjencia do të vazhdojë ekzistencën e saj operacionale për të ardhmen e parashikueshme, nisur nga objektivat e saj ligjore për kompensimin e depozitave si edhe ruajtjen e stabilitetit bankar e financiar dhe mbrojtjen e interesave të depozituesve.

3. Bazat e përgatitjes dhe zbatimit të SNRF-të (vazhdim)

(e) Parimi i vijimësisë (vazhdim)

Gjatë vitit 2024, ekonomia shqiptare përballoi dhe tejkaloi goditjet e shkaktuara nga rritja e çmimeve në tregjet botërore, duke ruajtur trendin e rimëkëmbjes pas pandemisë dhe pa cenuar ekuilibrat ekonomikë apo stabilitetin financiar të vendit.

Agjencia ka vijuar të operojë në përputhje me parimin e vijimësisë, duke ruajtur një bazë të qëndrueshme financiare dhe një menaxhim të kujdesshëm të aktiveve. Gjithashtu, ajo ka vijuar të menaxhojë efektivisht likuiditetin e saj, duke garantuar kapacitetin për të përmbushur detyrimet e mundshme dhe për të mbështetur qëndrueshmërinë e skemës së sigurimit të depozitave. Duke qenë se investimet mbahen deri në maturim, Agjencia ka raportuar stabilitet në vlerën e aktiveve të saj. Në këtë kontekst, nuk janë identifikuar pasiguri që mund të ndikojnë në aftësinë e Agjencisë për të vijuar veprimtarinë e saj në të ardhmen e parashikueshme.

Në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, bazuar në këtë perspektivë pozitive dhe në përputhje me planin financiar të miratuar për vitet në vijim, Agjencia parashikon zgjerimin e aktivitetit të saj operacional dhe synon të realizojë një rezultat pozitiv në vitin e ardhshëm.

4. Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të reja dhe të rishikuara të raportimit financiar

4.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024

Disa standarde të kontabilitetit që kanë hyrë në fuqi nga 1 janari 2024 dhe që kanë qenë të miratuara, nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin financiar të Agjencisë. Për këtë arsye, informacioni shpjegues në lidhje me këto standarde nuk është dhënë në pasqyrat e Agjencisë.

Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që janë efektive për herë të parë në vitin 2024 dhe që mund të zbatohen në Agjenci janë:

- Klasifikimi i pasiveve si korente ose afatgjata (Ndryshimet në SNK 1)
- Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthim me qira (Ndryshimet në SNRF 16)
- Marrëveshjet financiare të furnizuesit (Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7)
- Detyrimet afatgjata me marrëveshje (Ndryshimet në SNK 1)

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye nuk është bërë dhënia e informacioneve shpjeguese.

4.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Agjencia

Disa standarde dhe amendime që ende nuk janë efektive dhe që nuk janë adoptuar më herët nga Agjencia përfshijnë:

- Mungesa e shkëmbimit (Ndryshimet në SNK 21)
- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në SNRF 9 dhe 7)
- SNRF 18 "Prezantimi dhe shpalosja në pasqyrat financiare"
- SNRF 19 'Filiale pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese'

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

4. Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të reja dhe të rishikuara të raportimit financiar (vazhdim)

4.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Agjencia (vazhdim)

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare gjatë periudhës së aplikimit fillestar, dhe, prandaj, nuk është bërë dhënia e informacioneve shpjeguese.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, janë publikuar nga IASB ose IFRIC: disa standarde të reja por ende joefektive, disa ndryshime dhe shtesa në Standardet ekzistuese, si dhe disa Interpretime. Asnjë nga këto standarde apo ndryshime në standardet ekzistuese nuk janë adoptuar më herët nga Agjencia dhe nuk janë lëshuar Interpretime që janë të zbatueshme apo që duhet të merren në konsideratë në datën e raportimit nga Agjencia.

Drejtimi parashikon që të gjitha njoftimet e rëndësishme do të miratohen për herë të parë për periudhën që fillon në ose pas datës efektive të njoftimit. Standardet e reja, ndryshimet dhe Interpretimet e pa adoptuara në vitin aktual nuk janë shpalosur pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Agjencisë.

5. Përmbledhje e politikave materiale kontabël

5.1 Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e asaj date. Fitimi ose humbja nga zërat monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat e periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj e përkthyer me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet Jo-monetare të përkthyer në monedhë të huaj, të cilat mbahen me kosto historike, ripërkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit, të cilat janë rezultat i ri përkthimit, njihen në fitim/humbje.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore, të përdorura për të përkthyer zërat e bilancit në Lek janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
EURO	98.15	103.88
Dollari amerikan (USD)	94.26	93.94
Franga zvicerane (CHF)	104.27	112.10

5.2 Kontributet fillestare dhe primet e sigurimit të depozitave

Në përputhje me ligjin për sigurimin e depozitave nr. 53/14, datë 22.05.2014, i ndryshuar, primi i sigurimit të depozitave përlogaritet nga subjektet anëtare në baza tremujore. Për bankat primi tremujor i sigurimit përlogaritet si 0.125% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në bankë në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Për SHKK-të, primi tremujor i sigurimit është 0,075 përqind e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë të regjistruara në SHKK në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Për efekt të përlogaritjes së primeve, tremujori fillon ditën e parë të muajve janar, prill, korrik dhe tetor. Primi paguhet jo më vonë se data 15 e muajit të parë të tremujorit për të cilin paguhet.

Çdo subjekt, i cili kërkon të anëtarësohet në skemën e sigurimit të depozitave, paguan kontribut fillestar në masën 0,5 përqind të kapitalit fillestar të tij, të konvertuar në lekë, për të marrë vërtetimin për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave. Ky subjekt paguan në fund të vitit të parë të anëtarësimit në skemë shtesën e kontributit fillestar, që përlogaritet në masën 0,5 përqind të kapitalit të shtuar gjatë atij viti.

5. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)

5.3 Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Për aktivet financiare, ndryshe nga ato që janë blerë ose origjinuar me rrezik kredie të shtuar, norma e interesit efektiv është norma që aktualizon në mënyrë të saktë flukset e ardhshme hyrëse dhe dalëse të parave përgjatë jetës së pritshme të aktivit apo detyrimit financiar (ose, ku është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër) ndaj vlerës kontabël bruto të aktivit apo detyrimit financiar në njohjen fillestare. Për instrumentet financiare të blerë ose të origjinuar me rrezik të shtuar të kredisë, një normë e rregulluar efektive interesi llogaritet duke aktualizuar flukset e ardhshme të parasë duke përfshirë humbjet e pritshme ndaj kostos së amortizuar në njohjen fillestare të instrumentit.

Norma e interesit efektiv për instrumentet financiare të Agjencisë të cilët janë të gjithë të vlerësuar jo me rrezik të shtuar të kreditor është norma që aktualizon flukset hyrëse dhe dalëse të parave përgjatë jetës së pritshme të aktivit apo detyrimit financiar ndaj vlerës kontabël bruto të aktivit apo detyrimit financiar në njohjen fillestare.

5.4 Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë përbërëse e normës së interesit efektiv të një aktivi apo detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

5.5 Aktivët dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Agjencia i njeh fillimisht investimet në letra me vlerë, depozitat, huatë dhe detyrimet e tjera të varura në ditën në të cilën ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit, e cila është data kur Agjencia angazhohet të blejë apo shesë aktivet. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare (përfshirë dhe aktivet dhe detyrimet e mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data në të cilën Agjencia bëhet palë e dispozitave të kontratës së instrumentit.

(ii) Klasifikimi

Aktivët financiare

Një aktiv ose detyrim financiar, kur ky nuk përcaktohet si i matur me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, matet fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo shitjen e tij.

Klasifikimi i aktiveve financiare

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten pas njohjes fillestare me kosto të amortizuar:

- Instrumentet e borxhit të cilat mbahet sipas një modeli biznesi që ka si qëllim të mbajë këto aktive financiare për të përfutur të ardhurat kontraktuale; dhe
- në marrëveshjen bazë të emetimit të aktivit të përcaktohet që flukset hyrëse/kthimet do të shlyhen në data të caktuara dhe janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të përlogaritur mbi principalin e mbetur pa paguar.

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten pas njohjes fillestare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse:

- Instrumentet e borxhit të cilat mbahet sipas një modeli biznesi që ka si qëllim të mbajë këto aktive financiare për të përfutur të ardhurat kontraktuale; dhe
- Të shesë instrumentet financiare dhe të cilat kanë flukse hyrëse/kthime që do të shlyhen në data të caktuara dhe janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të përlogaritur mbi principalin e mbetur pa paguar.

5. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)

5.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Si rezultat të gjithë aktivet e tjera financiare maten me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes.

(i) Kosto e amortizuar dhe interesi efektiv

Kosto e amortizuar e aktivitetit financiar është shuma me të cilën matet aktivi në njohjen fillestare duke zbritur pagesat e principalit dhe duke shtuar amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të diferencës midis vlerës së njohur fillimisht dhe vlerës në maturim, të rregulluar për provigjonet nga humbjet. Vlera kontabël bruto e aktivitetit financiar është kosto e amortizuar e aktivitetit përpara rregullimit për ndonjë provigjon nga humbjet.

Aktivitetet financiare

Një aktiv ose detyrim financiar, kur ky nuk përcaktohet si i matur me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, matet fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo shitjen e tij.

Klasifikimi i aktiveve financiare

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten pas njohjes fillestare me kosto të amortizuar:

- Instrumentet e borxhit të cilat mbahet sipas një modeli biznesi që ka si qëllim të mbajë këto aktive financiare për të përfutur të ardhurat kontraktuale; dhe
- Në marrëveshjen bazë të emetimit të aktivitetit të përcaktohet që flukset hyrëse/kthimet do të shlyhen në data të caktuara dhe janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të përlogaritur mbi principalin e mbetur papaguar.

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten pas njohjes fillestare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse:

- Instrumentet e borxhit të cilat mbahet sipas një modeli biznesi që ka si qëllim të mbajë këto aktive financiare për të përfutur të ardhurat kontraktuale; dhe
- Të shesë instrumentet financiarë dhe të cilat kanë flukse hyrëse/kthime që do të shlyhen në data të caktuara dhe janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të përlogaritur mbi principalin e mbetur papaguar.

Si rezultat të gjithë aktivet e tjera financiare maten me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes.

Kosto e amortizuar e aktivitetit financiar është shuma me të cilën matet aktivi në njohjen fillestare duke zbritur pagesat e principalit dhe duke shtuar amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të diferencës midis vlerës së njohur fillimisht dhe vlerës në maturim, të rregulluar për provigjonet nga humbjet. Vlera kontabël bruto e aktivitetit financiar është kosto e amortizuar e aktivitetit përpara rregullimit për ndonjë provigjon nga humbjet.

Fitimi ose humbja nga konvertimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Specifikisht, për aktivitetet financiare që maten me Kosto të Amortizuar dhe që nuk janë pjesë e një marrëdhënie mbrojtëse të caktuar diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje;

Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, aktivitetet financiare të Agjencisë përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, dhe letrat me vlerë të klasifikuara si të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale. Nuk ka patur ndryshime në klasifikimin e aktiveve financiare përgjatë viteve të mbyllura më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023. Shiko Shënimet 5.6, 5.7 dhe 5.8.

5. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)

5.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

(i) Kosto e amortizuar dhe interesi efektiv (vazhdim)

Detyrimet financiare

Agjencia i klasifikon detyrimet e saj financiare, përveç garancive financiare dhe angazhimeve të huasë, si të matura me kosto të amortizuar ose me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 detyrimet financiare të Agjencisë përbëhen vetëm nga të pagueshmet ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera të matura me koston e amortizuar.

(iii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Agjencia njih një provigjon për humbjet e pritshme për aktivet financiare të cilat maten me kosto të amortizuar ose me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të gjithë përfshira. Shuma e humbjes së pritshme vlerësohet në çdo datë raportimi për të reflektuar ndryshimet në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare e instrumentit financiar. Agjencia gjithmonë vlerëson humbjet e pritshme për gjithë jetëgjatësinë e instrumentit financiar kur ka një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare. Megjithatë nëse nuk ka një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë Agjencia vlerëson provigjonin nga humbja e kredisë në shumën e humbjeve të pritshme për 12 muajt e jetës së aktivit financiar.

Humbjet e pritshme nga kredia për të gjithë jetën e aktivit financiar do të rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të humbjes përgjatë jetës së instrumentit financiar. Ndërkohë, humbja e pritshme për 12 muajt e fundit përfaqëson pjesën e humbjeve të pritshme nga humbjet e pritshme gjatë jetës së asetit që pritet të rezultojë nga ngjarjet e humbjeve që mund të ndodhin brenda 12 muajve pas datë së raportimit.

(i) Rritje e konsiderueshme në rrezikun e kredisë

Në vlerësimin nëse ka një rrezik të shtuar kredie për një instrument financiar që nga njohja fillestare, Agjencia krahason rrezikun e humbjes nga instrumenti financiar në datën e raportimit me rrezikun e humbjes në datën e njohjes fillestare. Në kryerjen e këtij vlerësimi, Agjencia konsideron informacionin sasior dhe cilësor që është i pranueshëm dhe i dokumentueshëm duke përfshirë eksperiencën historike dhe informacion mbi të ardhmen i cili mund të sigurohet pa shumë kosto dhe përpjekje. Informacion mbi kushtet e ardhshme konsideron perspektivat e ardhshme të sektorit në të cilën operon Agjencia, analiza financiare nga ekspertë financiarë, vlerësime nga agjenci ndërkombëtare vlerësimi, analiza nga institucione shtetërore apo organizata të tjera të ngjashme, si edhe burime të tjera të informacionit për parashikimin ekonomik aktual dhe të ardhshëm, i cili lidhet me aktivitete kryesore të Agjencisë. Veçanërisht, informacioni i mëposhtëm është marrë në konsideratë kur është vlerësuar nëse ka rritje të rrezikut të kredisë nga njohja fillestare:

- një përkeqësim aktual ose i pritshëm i vlerësimit të jashtëm ose të brendshëm të instrumentit financiar;
- përkeqësim i konsiderueshëm në treguesit e tregjeve të jashtme të treguesve të kredisë për instrumentet financiarë;
- ndryshime në rënie të kushteve ekonomike, dhe financiare aktuale ose të parashikuara të cilat presin të shkaktojnë një përkeqësim të aftësisë paguese të debitorit për të paguar detyrimet kontraktuale;
- një përkeqësim i konsiderueshëm aktual apo i pritshëm në rezultatet operative të debitorit;
- rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë në një instrument tjetër financiar të lëshuar nga i njëjti debitor.

Pavarësisht këtyre, Agjencia vlerëson që rreziku i kredisë për instrumentet financiar nuk është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga njohja fillestare nëse vlerësohet që instrumenti ka rrezik të ulët kredie në datën e raportimi.

5. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)

5.5 Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Një instrument ka rrezik të ulët kredie në datën e raportimi nëse:

1. Instrumenti financiar ka një rrezik të ulët humbjeje;
2. Debitori ka aftësi të forta paguese për të plotësuar detyrimet e tij kontraktuale në të ardhmen e afërt; dhe
3. Ndryshime të kundërta në kushtet ekonomike dhe kushtet e biznesit në afatgjatë të cilat jo domosdoshmërisht pakësojnë aftësinë e debitorit për të plotësuar detyrimet kontraktuale.

Agjencia konsideron që një aktiv financiar ka rrezik të ulët kredie kur aktivi ka vlerësime të jashtme si "investment grade" në përputhje me përkufizimin ndërkombëtar të njohur për këto investime ose nëse një vlerësim i jashtëm mungon, aktivi ka një vlerësim të brendshëm si aktiv financiar me performancë të mire, e cila konsideron që kundër pala ka një pozicion të fortë financiar dhe nuk ka detyrime në vonesë. Agjencia vlerëson në mënyrë të rregullt efektivitetin e kriterëve të përdorura për të identifikuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë dhe të rishikojë këto kriterë në mënyrë të përshtatshme për të siguruar që kriteret janë të vlefshme për të identifikuar një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë përpara se shumat e pritshme të jenë në vonesë.

(ii) Përkufizimi i humbjes

Agjencia konsideron ngjarjet e mëposhtme si evente të humbjes për qëllime të menaxhimit të brendshëm të rrezikut të kredisë pasi historiku i ngjarje ka treguar që nëse një aktiv financiar plotëson një nga kriteret e mëposhtme zakonisht nuk mund të arkëtohen:

- kur ka një thyerje të treguesve financiarë nga debitori; ose
- informacioni i krijuar së brendshmi apo i marrë nga burime të jashtme tregon që debitori ka pak mundësi pagese për kreditorët e tij duke përfshirë edhe Agjencinë.

Pavarësisht analizave të mësipërme, Agjencia konsideron që një humbje ka ndodhur kur aktivi financiar është më shumë se 90 ditë në vonesë për aq kohë sa Agjencia ka evidenca të arsyeshme dhe të mbështetura për të treguar se një kriter i ndryshëm humbjeje do të ishte më i përshtatshëm.

Matja e humbjeve të pritshme është një funksion i probabilitetit të humbjes, humbja e mundshme dhe ekspozimi ndaj humbjes. Vlerësimi i probabilitetit të humbjes dhe mundësisë së humbjes mbështetet në të dhëna historike të rregulluar me informacion për të ardhmen siç përshkruhet më sipër.

Ndërsa ekspozimi ndaj humbjes për aktivet financiare, përbëhet nga shuma bruto e aktivitetit në datën e raportimit. Për aktivet financiare, humbja e pritshme vlerësohet si diferenca midis të gjitha flukseve kontraktuale që i detyrohen Agjencisë sipas detyrimeve kontraktuale dhe flukseve të pritshme për tu marrë nga Agjencia të aktualizuara me normën origjinale efektive të interesit në momentin e investimit. Agjencia njeh një humbje apo të ardhur nga zhvlerësimi i të gjitha aktiveve financiare ne pasqyrën e fitim humbjes, me rregullimin përkatës në vlerën kontabël të tyre përmes një llogarie humbje nga provigjoni, me përjashtim të instrumenteve të matur me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse, për të cilat provigjoni njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe mbledhet në rezervën e rivlerësimit të investimeve dhe nuk pakëson vlerën kontabël të aktivitetit financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(iii) Çregjistrimi

Agjencia çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë përfundojnë apo i transferon të drejtat për të marrë flukset e parasë me anë të një transaksioni, i cili transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e ardhshme që rrjedhin nga pronësia e aktivitetit financiar, ose në të cilin Agjencia, as nuk mban dhe as nuk transferon në thelb rreziqet dhe përfitimet e ardhshme që rrjedhin nga pronësia dhe as nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar. Çdo interes i krijuar apo i mbajtur nga Agjencia mbi aktivet financiare të transferuara, të cilat kualifikohen për çregjistrim, njihet më vete si aktiv apo detyrim.

5. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)

5.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Në çregjistrimin e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit (ose vlerës së mbartur që i alokohet pjesës së transferuar të aktivitetit) dhe shumës së (i) shumave të marra (përfshirë çdo aktiv të ri në zotërim minus çdo detyrim të ri të marrë) dhe (ii) çdo fitim apo humbje kumulative të njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse, njihet në fitim/ humbje.

Detyrimet financiare

Agjencia çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale të saj janë përmbushur, ndërprerë apo anuluar.

(iv) Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten me shumën neto në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur, Agjencia ka një të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe kur ajo ka si qëllim ose t'i shlyejë ato me vlerën neto ose ta realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten me bazë neto vetëm kur lejohet nga SNRF-të, ose për fitim/humbje që rrjedhin nga transaksione të ngjashme.

(v) Matja e kostos së amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi apo detyrimi financiar është vlera, me të cilën është njohur në fillim aktivi apo detyrimi financiar, minus pagesat e shlyerjes së principalit, plus apo minus amortizimin e akumuluar, duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë midis shumës fillestare të njohjes dhe shumës në maturim, minus çdo zbritje apo zhvlerësim.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është çmimi, me të cilën një aktiv do të këmbehej, ose një detyrim do të shlyhej, në një transaksion të kryer në mënyrë të vullnetshme, mes palëve të gatshme, të mirë informuara dhe të palidhura me njëra-tjetrën, në datën e matjes.

Kur është e mundur, Agjencia mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e listuar në një treg aktiv të këtij instrumenti. Një treg konsiderohet aktiv, nëse çmimet e listuara janë direkt dhe rregullisht të disponueshme dhe përfaqësojnë transaksione aktuale dhe të rregullta të tregut, të kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën. Kur nuk ka çmim të listuar në një treg aktiv, Agjencia përdor ato teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave përkatëse të verifikueshme dhe minimizojnë ato jo të verifikueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët, që pjesëmarrësit në treg do të merrnin parasysh në përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Informacioni më i mirë për të përcaktuar vlerën e drejtë të një instrumenti financiar gjatë njohjes fillestare të tij është normalisht çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e shumës së dhënë apo marrë. Nëse Agjencia përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk përcaktohet, as me anë të një çmimi të listuar në një treg aktiv për një aktiv apo detyrim të njëjtë dhe as duke u bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna nga tregje të verifikueshme, instrumenti financiar fillimisht njihet me vlerën e drejtë, të rregulluar, për të shmangur diferencën midis vlerës së drejtë në njohje dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim/humbje mbi një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se koha kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhëna të verifikueshme të tregut apo transaksioni është mbyllur.

Nëse një aktiv apo detyrim i matur me vlerën e drejtë, ka një çmim oferte dhe një çmim kërkesë, Agjencia i mat aktivet dhe pozicionet e gjata me çmim oferte dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmim kërkesë.

Politika kontabël e matjes me vlerën e drejtë e Agjencisë është paraqitur në Shënimin 7.1.

5. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)

5.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Agjencia mat vlerën e drejtë duke ndjekur renditjen e mëposhtme të vlerave të drejta që pasqyrojnë rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjeve:

- **Kategoria 1:** të dhëna që janë çmimet e tregut të listuara (të parregulluara), në një treg aktiv për instrumente të njëjtë.
- **Kategoria 2:** të dhëna, të ndryshme nga çmimet e listuara në treg të përfshira në nivelin 1, të cilat janë të verifikueshme si drejtpërdrejt (si p.sh. çmimet) apo jo drejtpërdrejt (p.sh. të rrjedhura nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumentet e vlerësuar duke përdorur: çmimet e tregut të listuara në një treg aktiv të instrumenteve të ngjashëm; çmimet e listuara të instrumenteve të njëjtë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktiv; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të verifikueshme drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt me të dhënat e tregut.
- **Kategoria 3:** të dhëna jo të verifikueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet, në të cilat teknikat e vlerësimit përfshijnë të dhëna jo të bazuara në informacione të verifikueshme dhe ku të dhënat jo të verifikueshme kanë ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që vlerësohen në bazë të çmimeve të listuara për instrumente të ngjashëm, që kërkojnë rregullime apo supozime të paverifikueshme, të rëndësishme për të pasqyruar diferencat midis instrumenteve.

Vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare, të tregtueshme në tregje aktive, bazohen në çmimet e tregut të listuara apo listimet e çmimeve nga ana e tregtuesit. Për të gjithë instrumentet e tjerë financiarë, Agjencia përcakton vlerat e drejta duke përdorur teknika të tjera vlerësimi.

Teknika të tjera vlerësimi përfshijnë modelet e vlerës aktuale neto dhe të aktualizimit të flukseve të parasë dhe krahasime me instrumente të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime të verifikueshme të tregut.

Qëllimi i teknikave të vlerësimit është matja e një vlere të drejtë, e cila të reflektojë çmimin që do të ishte marrë në shitje të aktivit apo do të ishte paguar për transferimin e detyrimit, në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Çmimet e verifikueshme dhe të dhënat e modelit janë zakonisht të disponueshme në tregjet e letrave me vlerë, derivativëve të tregtueshëm dhe derivativëve të thjeshtë mbi banak (jashtë bursave) si suopet e normës së interesit. Disponueshmëria e çmimeve të verifikueshme të tregjeve dhe të dhënave të modelit ul nevojën e gjyimeve dhe vlerësimeve nga ana e Drejtimit dhe gjithashtu ul pasigurinë lidhur me përcaktimin e vlerave të drejta. Disponueshmëria e çmimeve dhe të dhënave të verifikueshme të tregjeve luhet në varësi të produkteve dhe tregjeve, si dhe priret të ndryshojë në bazë të kushteve të përgjithshme dhe ngjarjeve të caktuara në tregjet financiare.

5.6 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, llogaritë rrjedhëse me bankat dhe depozitat shumë likuide në Bankën e Shqipërisë me afat maturimi tre muaj ose më pak, që janë të ekspozuara ndaj një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë dhe që përdoren nga Agjencia në administrimin e aktivitetit të saj. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila përafrohet me vlerën e drejtë për shkak të natyrës afatshkurtër të tyre.

5.7 Primet e sigurimit të arkëtueshme

Primet e sigurimit të arkëtueshme mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila përafrohet me vlerën e drejtë për shkak të natyrës afatshkurtër të tyre.

5. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)

5.8 Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale

Një aktiv ose detyrim financiar, kur ky nuk përcaktohet si i matur me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, matet fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo shitjen e tij. Aktivet financiare të Agjencisë klasifikohen si të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale sepse modeli i biznesit të Agjencisë është mbajtja e këtyre aktiveve financiare për të përfituar të ardhura kontraktuale dhe në marrëveshjen bazë të emetimit të aktivit të përcaktohet që flukset hyrëse/kthimet do të shlyhen në data të caktuara dhe janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të përlogaritur mbi principalin e mbetur pa paguar.

5.9 Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto, minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje e akumuluar nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjithë shpenzimet, të cilat lidhen direkt me blerjen e një aktivi.

Çdo fitim apo humbje në nxjerrjen jashtë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (e llogaritur si diferenca midis të hyrave neto nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël neto) njihet si "Të ardhura të tjera" në pasqyrën e fitim/humbjes.

(ii) Kosto e mëpasshme

Një shpenzim i mëpasshëm kapitalizohet vetëm kur është e mundur që Agjencisë t'i rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike nga ky shpenzim. Riparimet dhe mirëmbajtjet e vazhdueshme njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet për të alokuar koston minus vlerën e mbetur të vlerësuar të një zëri të aktiveve afatgjata materiale në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar. Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitim/humbjes. Aktivet e marra me qira financiare amortizohen përgjatë afatit më të shkurtër, mes jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së qirasë. Toka nuk amortizohet. Llogaritjet e jetës së dobishme të zërave të rëndësishme të pronave dhe pajisjeve, për periudhën aktuale dhe ato të krahasueshme, janë si më poshtë:

• Ndërtesa dhe përmirësime	25-40 vjet
• Pajisje kompjuterike	3-5 vjet
• Auto vetura	5 vjet
• Pajisje zyre	3-20 vjet
• Instalime Teknike	4-20 vjet

Metodat e zhvlerësimit, jetët e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen kur është e përshtatshme.

5.10 Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivët afatgjata jo-materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjithë shpenzimet, të cilat lidhen direkt me blerjen e një aktivi. Një shpenzim i mëpasshëm kapitalizohet vetëm kur është e mundur që Agjencisë t'i rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike nga ky shpenzim. Riparimet dhe mirëmbajtjet e vazhdueshme njihen si shpenzime kur ato ndodhin. Aktivët afatgjata jo-materiale amortizohet në mënyrë lineare për një periudhë tre deri katër vjeçare.

Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen kur është e përshtatshme.

5. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)

5.11 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Agjencia ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkohej një dalje e përfitimeve ekonomike për të shlyer detyrimin.

Provigjonet për kompensimin e depozitave të siguruara

Provigjonet për kompensimin e depozitave të siguruara paraqesin vlerësimet më të mira të Agjencisë për detyrimet aktuale, si rezultat i një ndërhyrjeje në një institucion të siguruar, për të cilin Agjencia është njoftuar me shkrim nga Banka e Shqipërisë ose kur ky institucion likuidohet vullnetarisht. Një provigjon i tillë njihet në periudhën kur ka filluar likuidimi vullnetar i institucionit ose kur është njoftuar me shkrim nga Banka e Shqipërisë për ndërhyrjen në këtë institucion.

Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 nuk kanë ndodhur ngjarje të tilla (shiko Shënimin 6.3), ndaj nuk është njohur ndonjë provigjon në pasqyrën e pozicionit financiar.

5.12 Tatimet dhe Taksat

Në përputhje me Ligjin "Për sigurimin e depozitave" Agjencia është e përfshirë nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe tatimi mbi fitimin. Agjencia është subjekt i tarifave dhe taksave vendore.

5.13 Kontributet dhe përfitimet e punonjësve

Agjencia paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit. Autoritetet vendase janë përgjegjëse për të përcaktuar kufijtë ligjorë për këto kontribute në Shqipëri. Kontributet e Agjencisë, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit njihen në pasqyrën e fitim/humbjes kur ato ndodhin.

5.14 Krahaseshmëria

Disa vlera krahasuese në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare dhe pasqyrës së ndryshimeve në fondet e sigurimit të depozitave janë ri klasifikuar ose ri paraqitur si rezultat i një ndryshimi në klasifikim për të pasqyruar një efekt më të mirë.

6. Menaxhimi i rrezikut financiar

Gjatë rrjedhjes së zakonshme të veprimtarisë, Agjencia është e ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh financiare, ku më të rëndësishmit janë rreziku i tregut (ku përfshihet rreziku i monedhës, rreziku i ndryshimeve në vlerën e drejtë dhe në normat e interesit), rreziku kreditor dhe rreziku i likuiditetit. Administrimi i rrezikut në përgjithësi fokusohet në identifikimin e rreziqeve, që mund të ndikojnë në rezultatet dhe pozicionin financiar të Agjencisë, si dhe në minimizimin e efekteve negative potenciale që mund të vijnë nga këto rreziqe.

Rreziqet financiare aktualisht identifikohen, maten dhe kontrollohen përmes mekanizmave të ndryshme, të ndërmarra për të vlerësuar si duhet ngjarjet e tregut lidhur me investimet dhe mënyrat e mbajtjes së aktiveve likuide me qëllim parandalimin e përqendrimit të tepruar të rrezikut.

Drejtimi i ASD-së përpaket të përmirësuar metodat e vlerësimit dhe administrimit të rreziqeve lidhur me portofolin e investimeve (rrezikun e kredisë, likuiditetit, interesit dhe monedhës), me qëllim sigurimin e administrimit efektiv të fondeve dhe përmbushjen në kohë të detyrimeve të Agjencisë ndaj depozituesve të siguruar në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Administrimi i mjeteve financiare të Agjencisë rregullohet nga ligji për sigurimin e depozitave dhe Rregullorja "Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave" ("Politika e Investimit"), e miratuar nga Këshilli Drejtues.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE **Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare**

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Politika e investimit përcakton strukturën e portofoleve sipas fondeve të administruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, kriteret për minimizimin e rreziqeve në administrim, dhe kushtet e procedurat për vendimmarrjen dhe zbatimin e administrimit të mjeteve financiare.

Administrimi i mjeteve financiare të Agjencisë kryhet duke ndjekur këto parime:

- a) parimi i likuiditetit, sipas të cilit titujt në të cilët janë investuar mjetet financiare duhet të kthehen në lekë sa më shpejt dhe me kosto sa më të ulët;
- b) parimi i sigurisë, sipas të cilit portofolet e Agjencisë diversifikohen dhe mjetet financiare investohen në tituj të ndryshëm nga lloji dhe/ose maturimi dhe me rrezik kreditor sa më të ulët; dhe
- c) parimi i normës së kthimit, sipas të cilit duhet të synohet që norma reale e kthimit nga instrumentet financiare në të cilët janë investuar mjetet të jetë sa më e lartë.

Për qëllime të administrimit, mjetet financiare organizohen në dy transhe. Transhi i likuiditetit shërben për mbulimin e nevojave në rast ngjarjeje sigurimi të mundshme dhe nevojave për mbulimin e shpenzimeve për veprimtarinë vjetore të Agjencisë. Ky transh është ndryshuar në dhjetor 2018 duke përfshirë gjendjen në llogaritë rrjedhëse, depozitat, si dhe titujt me maturitet të mbetur nga 0 - 3 muaj. Më parë ky transh përfshinte llogaritë rrjedhëse, depozitat, si dhe titujt me maturitet të mbetur në momentin e blerjes nga Agjencia nga 0 - 3 muaj. Gjatë vitit 2024, transhi i likuiditetit nuk ka pasur ndryshim. Madhësia e këtij transhi në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 10% e totalit të mjeteve financiare për secilin nga fondet e administruara nga Agjencia. Transhi i investimit përfaqëson mjetet financiare pasi zbritet transhi i likuiditetit. Ky transh përfshin titujt me maturitet të mbetur deri në 15 vjet. Titujt me maturitet të mbetur mbi 2 vjet nuk mund të kenë një vlerë më të madhe se 40% e totalit të mjeteve financiare për secilin nga fondet. Me qëllim minimizimin e rreziqeve, transhi i investimit duhet të synojë një shpërndarje të shkallëzuar të maturiteteve. Kalimi nga ky transh në transhin e likuiditetit kryhet në përputhje me nevojat e Agjencisë për mjete likuide. Madhësitë e transheve të likuiditetit dhe të investimit përcaktohen mbi bazë të analizave periodike mbi gjendjen financiare të sistemit bankar dhe shoqërive të kursim kreditorit.

Instrumentet financiar të lejuar rregullohen nga ligji për sigurimin e depozitave dhe politika e investimit. Sipas këtyre akteve mjetet financiare të investohen në tituj të emetuar nga qeveri ose banka qendrore të huaja të vlerësuar si të sigurta nga agjenci të njohura të vlerësimit të kreditit (vlerësim jo më të ulët se AA-/Aa3) ose tituj të emetuar nga Qeveria e Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë. Gjithashtu mjetet financiare mund të vendosen në depozita afatshkurtra/llogari rrjedhëse në Bankën e Shqipërisë ose institucione financiare ndërkombëtare të vlerësuar si të sigurta nga agjenci të njohura të vlerësimit të kreditit (vlerësim jo më të ulët se AA-/Aa3).

Me qëllim administrimin e rrezikut ndaj monedhës dhe luhatjeve në kursin e këmbimit, Mjetet financiare mbahen në lek dhe monedhë të huaj. Monedhat e huaja të lejuara janë dollar Amerikan dhe Euro. Peshat e secilës monedhë përcaktohet në strategjinë vjetore të investimit të mjeteve financiare. Mjetet financiare në monedhë të huaj për fondin e sigurimit të depozitave në Banka nuk duhet të jenë më pak se 5% e totalit të mjeteve financiare të këtij fondi bazuar në Rregulloren Nr. 17, datë 28.07.2016 "Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të ASD", e ndryshuar. Në një periudhë afatgjatë, duke konsideruar kushtet e tregut, Agjencia synon që shpërndarja e portofolit të orientohet drejt përafrimit të mundshëm me shpërndarjen e depozitave të siguruar sipas monedhave.

Gjithashtu, me qëllim garantimin e aftësisë për të përmbushur detyrimet ndaj depozituesve të siguruar, Agjencia ka hyrë në një marrëveshje me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, e cila e lejon atë në rast ngjarjeje sigurimi, të sigurojë likuiditet duke zbatuar me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, një marrëveshje shitjeje dhe riblerjeje të letrave me vlerë të Qeverisë së Shqipërisë që ajo zotëron. Në përputhje me ligjin për sigurimin e depozitave, në rast të pamjaftueshmërisë së fondeve, Agjencia ka të drejtë të kërkojë pagesa të parakohshme të primeve vjetore të sigurimit nga institucionet e siguruar, të rrisë primet vjetore, të mbledhë një kontribut të veçantë nga institucionet e siguruar dhe të marrë hua nga Buxheti i Shtetit (Neni 61 i ligjit "Për sigurimin e depozitave").

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

6.1 Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare i shkaktuar Agjencisë nëse pala tjetër në një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe vjen kryesisht nga investimet në letra me vlerë të Agjencisë dhe gjendjeve të llogarive në banka. Për qëllime raportimi lidhur me administrimin e rrezikut, Agjencia merr parasysh dhe përfshin të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor, siç janë rreziku i dështimit të debitorëve individualë dhe rreziku i shtetit.

Komiteti i Investimeve është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut kreditor, përfshirë rishikimin dhe vlerësimin e rrezikut kreditor, si dhe garantimin e përputhshmërisë me kufijtë e vendosur në lidhje me ekspozimin ndaj palëve të treta/shteteve dhe me politikat e tjera përkatëse të përcaktuara në aktet nënligjore.

Tabela më poshtë paraqet ekspozimin ndaj rrezikut kreditor sipas palëve të treta (shteteve) dhe vonesat në ri pagim apo zhvlerësimet e lidhura me to, nëse ka:

Investimet në letra me vlerë	Qeveria e Shqipërisë	Totali
Më 31 dhjetor 2024		
Jo me vonesë apo të zhvlerësuar	59,238,457,694	59,238,457,694
Jo me vonesë por të zhvlerësuar sipas kërkesave të SNRF 9	9,015,420,826	9,015,420,826
TOTALI	68,253,878,520	68,253,878,520

Më 31 dhjetor 2023		
Jo me vonesë apo të zhvlerësuar	54,010,554,151	54,010,554,151
Jo me vonesë por të zhvlerësuar sipas kërkesave të SNRF 9	8,308,326,501	8,308,326,501
TOTALI	62,318,880,652	62,318,880,652

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	Banka e Shqipërisë	Banka të nivelit të dytë	Totali
Më 31 dhjetor 2024			
Jo me vonesë apo të zhvlerësuar	2,059,382,046	2,574,376	2,061,956,422
Jo me vonesë por të zhvlerësuar sipas kërkesave të SNRF 9	1,061,440	33,046,136	34,107,576
TOTALI	2,060,443,486	35,620,512	2,096,063,998
Më 31 dhjetor 2023			
Jo me vonesë apo të zhvlerësuar	1,384,325,266	12,487,039	1,396,812,305
Jo me vonesë por të zhvlerësuar sipas kërkesave të SNRF 9	4,457,955	3,682,928	8,140,883
TOTALI	1,388,783,221	16,169,967	1,404,953,188

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)

Tabela më poshtë paraqet instrumentet financiare për vitin 2024 dhe 2023 sipas shkallëve të SNRF 9

Shkallët sipas Humbjes së Pritshme nga aktivet financiare më 31 dhjetor 2024

	Shkalla 1	Shkalla 2	Shkalla 3	Totali
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale	68,267,667,934	-	-	68,267,667,934
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	2,096,063,998	-	-	2,096,063,998
Vlera bruto	70,363,731,932	-	-	70,363,731,932
Provizjonet	(13,789,414)	-	-	(13,789,414)
Vlera kontabël, neto	70,349,942,518	-	-	70,349,942,519

Shkallët sipas Humbjes së Pritshme nga aktivet financiare më 31 dhjetor 2023

	Shkalla 1	Shkalla 2	Shkalla 3	Totali
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale	62,335,622,840	-	-	62,335,622,840
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	1,404,953,188	-	-	1,404,953,188
Vlera bruto	63,740,576,028	-	-	63,740,576,028
Provizjonet	(16,742,188)	-	-	(16,742,188)
Vlera kontabël, neto	63,723,833,840	-	-	63,723,833,840

Agjencia nuk ka angazhime financiare të kushtëzuara më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023.

Agjencia përdor klasifikimet e rrezikut kreditor për aktivet dhe detyrimet financiare të publikuara nga njësite ndërkombëtare S&P për përcaktimin e probabilitetit të dështimit si më poshtë:

Klasifikimi sipas S&P viti 2024	Institucioni	Probabiliteti i dështimit
BB-	Qeveria e Shqipërisë	0.81%
BB-	Banka e Shqipërisë	0.81%
BBB+	Raiffeisen Bank International AG	0.08%
BBB+	Raiffeisen Bank Shqipëri	0.23%
Nuk ka vlerësim	Banka Credins	-
Nuk ka vlerësim	Banka Kombëtare Tregtare	0.23%
Nuk ka vlerësim	Intesa San Paolo	-

Klasifikimi sipas S&P viti 2023	Institucioni	Probabiliteti i dështimit
B+	Qeveria e Shqipërisë	0.61%
B+	Banka e Shqipërisë	0.61%
BBB+	Raiffeisen Bank International AG	0.08%
BBB+	Raiffeisen Bank Shqipëri	0.23%
Nuk ka vlerësim	Banka Credins	-
Nuk ka vlerësim	Banka Kombëtare Tregtare	0.23%
BBB	Intesa San Paolo	-

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

6.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku ndryshimit të çmimit të tregut të aktiveve, si rezultat i një ndryshimi të normave të interesit, kurseve të këmbimit dhe marzhet në interesat e kredisë (jo lidhur me ndryshimet në cilësinë e kreditimit të emetuesit/debitorit), të cilët do të ndikojnë në të ardhurat e Agjencisë ose vlerën e instrumenteve financiare të zotëruar prej saj. Qëllimi i Agjencisë në administrimin e rrezikut të tregut është drejtimi dhe kontrolli mbi ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, me qëllim sigurimin e aftësisë pagueuese të Agjencisë duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

(i) Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - investimet e mbajtura për të mbledhur flukse sipas maturitetit të mbetur

Rreziku kryesor, ndaj të cilit janë ekspozuar portofolet jo-të-tregtueshme, është rreziku i humbjeve nga luhatjet e flukseve të ardhshme të parasë të instrumenteve financiare ose vlerave të drejta të tyre, për shkak të një ndryshimi në normat e interesit në treg. Rreziku i normës së interesit administrohet kryesisht duke monitoruar ekspozimin neto në instrumentet financiare që mbartin interes dhe duke miratuar paraprakisht kufijtë për këto ekspozime. Komiteti i Investimeve është organi mbikëqyrës i përputhshmërisë me këto kufij.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare
(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

6.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

(i) *Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukset sipas afatit të mbetur (vazhdim).*

Një përmbledhje e pozicionit neto të Agjencisë në portofolet jo-të-tregtueshme paraqitet si më poshtë:

	Vlera kontabël neto	deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	12 - 24 muaj	2 – 5 vjet	5 - 10 vjet
Më 31 dhjetor 2024								
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	2,096,063,998	2,096,063,998	-	-	-	-	-	-
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale	68,253,878,520	1,959,500,000	6,000,565,000	6,544,990,000	10,906,785,826	19,803,308,947	8,590,225,000	14,448,503,747
TOTALI	70,349,942,518	4,055,563,998	6,000,565,000	6,544,990,000	10,906,785,826	19,803,308,947	8,590,225,000	14,448,503,747
Më 31 Dhjetor 2023								
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	1,404,953,188	1,404,953,188						
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale	62,318,880,652	4,501,495,702	3,515,055,927	6,239,444,371	13,292,467,980	16,156,865,754	7,902,473,963	10,711,076,955
TOTALI	63,723,833,840	5,906,448,890	3,515,055,927	6,239,444,371	13,292,467,980	16,156,865,754	7,902,473,963	10,711,076,955

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

6.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

(i) *Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale (vazhdim)*

Drejtimi mori parasysh një skenar standard që përfshin një ulje ose rritje paralele prej 100 pikësh bazë (bp) në të gjitha kurbat e normave të interesit në botë. Një analizë e ndjeshmërisë së Agjencisë ndaj një rritjeje apo uljeje në normat e interesit të tregut paraqitet më poshtë:

Ndryshimi në normë	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
+100bp	703,499,423	637,238,338
-100bp	(703,499,423)	(637,238,338)

(ii) *Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit*

Rreziku i monedhës përkufizohet, si rreziku që luhet në kurset e këmbimit të shkaktojnë ndryshime të rëndësishme, pozitive ose negative, në pasqyrën e pozicionit financiar. Agjencia është kryesisht e ekspozuar ndaj rrezikut të ndryshimeve në kursin e këmbimit të Euros dhe USD ndaj Lekut. Ekspozimet aktuale dhe kufizimet lidhur me to vendosen dhe monitorohen në përputhje me Politikën e Investimit të Agjencisë.

Një përmbledhje e ekspozimit neto ndaj monedhës paraqitet më poshtë (vlerat në LEK):

Më 31 dhjetor 2024	LEK	USD	EUR
Aktivët			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	2,061,956,423	398,314	33,709,261
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale	59,224,668,280	-	9,029,210,240
Aktive të tjera	4,427,068	-	-
Totali	61,291,051,771	398,314	9,062,919,501
Detyrimet			
Detyrime të tjera	(16,580,902)	-	-
Totali i detyrimeve	(16,580,902)	-	-
Ekspozimi neto ndaj kursit të këmbimit	61,274,470,869	398,314	9,062,919,501
Më 31 dhjetor 2023	LEK	USD	EUR
Aktivët			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	1,396,812,305	585,782	7,555,101
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale	54,010,554,151	-	8,308,326,501
Aktive të tjera	5,822,416	-	-
Totali	55,413,188,872	585,782	8,315,881,602
Detyrimet			
Detyrime të tjera	(13,923,794)	-	-
Totali i detyrimeve	(13,923,794)	-	-
Ekspozimi neto ndaj kursit të këmbimit	55,399,265,078	585,782	8,315,881,602

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

6.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

Analiza e ndjeshmërisë ndaj monedhës së huaj

Tabela më poshtë paraqet ndjeshmërinë ndaj një rritje/rënie me 1,500 pikë bazë në kurset e këmbimit të LEK-ut ndaj USD dhe EUR në datën e raportimit bazuar në strukturën e aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të huaj të Agjencisë më 31 dhjetor, duke supozuar se të gjithë variablat e tjerë mbeten të pandryshuar. Efekti është matur dhe paraqitur si një ndikim në rezultat dhe direkt në aktivet neto, duke mbajtur të pandryshuara kushtet e tjera.

	USD		EUR	
	+15%	-15%	+15%	-15%
Më 31 dhjetor 2024	59,747	(59,747)	1,359,437,925	(1,359,437,925)
Më 31 dhjetor 2023	87,867	(87,867)	1,247,382,240	(1,247,382,240)

Me një rritje prej 15 përqind në kursin e këmbimit të USD dhe EUR ndaj LEK-ut në datën e raportimit, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar dhe aktivet neto të Agjencisë do të ishte një rritje me vlerë si në tabelën e mësipërme.

Me një ulje prej 15 përqind në kursin e këmbimit të USD dhe EUR ndaj LEK-ut në datën e raportimit, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar dhe aktivet neto të Agjencisë do të ishte i njëjtë, por në drejtim të kundërt me ndikimin e rritjes së përshkruar më sipër.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare
(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

6.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Agjencia do të përballët me vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të saj financiare që shlyhen duke dhënë para apo një aktiv tjetër financiar. Politika e administrimit të likuiditetit të ASD-së është konservatore, duke mbajtur një rezervë optimale e të qëndrueshme mjeteve monetare dhe burimesh shtese financiare për të siguruar kapacitetin e duhur për financimin e aktiviteve të saj. Për më shumë informacion mbi politikën e administrimit të mjeteve dhe burimeve shtesë financiare referohuni në fillim të shënimit 6.

Tabela më poshtë paraqet instrumentet financiarë të Agjencisë të klasifikuara sipas periudhës së mbetur dhe parave kontraktuale të aktualizuara:

Më 31 dhjetor 2024	Vlera kontabël neto në lek	deri në 1 muaj në lek	1 - 3 muaj në lek	3 - 6 muaj në lek	6 - 12 muaj në lek	12 - 24 muaj në lek	2 - 5 vjet në lek	5 - 10 vjet në lek	Flukset totale Kontraktuale të parashë në lek
AKTIVET									
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	2,096,063,998	2,096,063,998	-	-	-	-	-	-	2,096,063,998
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale	68,253,878,998	1,959,500,000	6,000,565,000	6,544,990,000	10,906,785,826	19,803,308,947	8,590,225,000	14,448,503,747	68,253,878,520
TOTALI	70,349,942,518	4,055,563,998	6,000,565,000	6,544,990,000	10,906,785,826	19,803,308,947	8,590,225,000	14,448,503,747	70,349,942,518
DETYRIMET									
Detyrime të tjera	16,580,902		16,580,902	-	-	-	-	-	16,580,902
TOTALI									
HENDEKU									
KUMULATIV I									
LIKUIDITETIT	70,333,361,616	4,055,563,998	5,983,984,098	6,544,990,000	10,906,785,826	19,803,308,947	8,590,225,000	14,448,503,747	70,333,361,616

Me 31 dhjetor 2024 transhi i likuiditetit është 12.55%, transhi për instrumentet financiare me afat 3-24 muaj është 53.93% dhe transhi i investimeve 33.52%.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare
(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

6.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2023	Vlera kontabël neto në lek	deri në 1 muaj në lek	1 - 3 muaj në lek	3 - 6 muaj në lek	6 - 12 muaj në lek	12 - 24 muaj në lek	2 - 5 vjet në lek	5 - 10 vjet në lek	Flukset totale Kontraktuale të parashë në lek
AKTIVET									
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	1,404,953,188	1,404,953,188	-	-	-	-	-	-	1,404,953,188
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale	62,318,880,652	4,501,495,702	3,515,055,927	6,239,444,371	13,292,467,980	16,156,865,754	7,902,473,963	10,711,076,955	62,318,880,652
TOTALI	63,723,833,840	5,906,448,890	3,515,055,927	6,239,444,371	13,292,467,980	16,156,865,754	7,902,473,963	10,711,076,955	63,723,833,840
DETYRIMET									
Detyrime të tjera	13,923,795	7,705,196	6,218,598	-	-	-	-	-	13,923,795
TOTALI HENDEKU KUMULATIV	13,923,795	7,705,196	6,218,598	-	-	-	-	-	13,923,795
LIKUIDITETIT	63,709,910,045	5,898,743,694	3,508,837,329	6,239,444,371	13,292,467,980	16,156,865,754	7,902,473,963	10,711,076,955	63,709,910,045

Me 31 dhjetor 2023 transhi i likuiditetit është 12.97 %, transhi për instrumentet financiare me afat 3-24 muaj është 58.24% dhe transhi i investimeve 28.79%.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

6.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Qëndrueshmëria financiare

Qëndrueshmëria e sektorit bankar është faktori kryesor që ndikon në pozicionin e likuiditetit të Agjencisë. Agjencia, në bazë të informacionit të marrë nga Banka e Shqipërisë, vlerëson vazhdimisht qëndrueshmërinë e sektorit bankar në mënyrë që të parashikojë detyrimet e saj kundrejt depozituesve të siguruar, në përputhje me ligjin "Për sigurimin e depozitave".

Sipas raportit më të fundit mbi stabilitetin financiar, Banka e Shqipërisë vlerëson sektorit bankar u tkurr lehtë, nën efektin statistikor të mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut. Sipas zërave të aktivitetit, në këtë ecuri kontribuan kryesisht rënia në vlerën e raportuar të veprimeve me thesarin dhe ato ndër bankarë, si dhe tkurrja e kredisë, ku përdorimi i valutës është relativisht më i lartë. Nga ana tjetër sektori bankar ka rritur investimet në tituj dhe ka tkurrur provigjonet për aktivet. Në krahun e pasivit, ndikimi kryesor pakësues i mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut u ndje në vlerën e raportuar të depozitave dhe të kapitalit.

Rreziku i likuiditetit në aktivitetin e sektorit bankar mbetet i kontrolluar. Treguesit kryesorë të likuiditetit për monedhën vendase dhe të huaj vijnë të jenë dukshëm mbi kufijtë minimalë të përcaktuar nga aktet rregullatore. Aktiviteti likuide janë zgjeruar me ritme disi më të shpejta në krahasim me detyrimet afatshkurtra, dhe treguesi kryesor i rrezikut të likuiditetit është përmirësuar lehtë.

7. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjyqimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjyqime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatueshmërinë e politikave kontabël dhe vlerave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën, në të cilën këto vlerësime janë rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të ndikuar nga këto rishikime.

Drejtimi diskuton me Këshillin Drejtues të Agjencisë zhvillimin, përzgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kontabël të rëndësishme dhe zbatueshmërinë e tyre dhe supozimet e bëra lidhur me pasiguritë kryesore në vlerësim. Informacionet mbi supozimet dhe pasiguritë në vlerësim, që kanë një rrezik të rëndësishëm që të rezultojnë në korrigjim material në vitin e ardhshëm financiar, dhe informacione mbi gjyqime të rëndësishme gjatë zbatimit të politikave kontabël, që kanë ndikimin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare, janë paraqitur më poshtë.

Drejtimi mori parasysh një skenar standard që përfshin një ulje ose rritje paralele prej 10% në treguesin e mundësisë së humbjes (PH) dhe treguesin e humbjes së mundshme nga kredia (HMK). Një analizë e ndjeshmërisë së humbjeve të mundshme nga kredia të Agjencisë ndaj një rritjeje apo uljeje në treguesit e matjes së humbjes paraqitet më poshtë:

	PH dhe HMK	
	+10%	-10%
Provigjoni më 31 dhjetor 2024 për mjetet monetare	398,185	(398,185)
Provigjoni për aktivet financiare	1,378,941	(1,378,941)
	PH dhe HMK	
	+10%	-10%
Provigjoni më 31 dhjetor 2023 për mjetet monetare	15.3	(15.3)
Provigjoni për aktivet financiare	1,674,218	(1,674,218)

Këto pasqyra plotësojnë shënimet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shiko Shënimin 6).

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

7. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

7.1 Vlerësimi i instrumenteve financiarë

Klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta të instrumenteve financiare janë të paraqitura më poshtë:

	Investime të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj)	Investime të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj)	Investime të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH)	Të tjera me koston e amortizuar	Vlera kontabël neto	Vlera e drejtë
Më 31 dhjetor 2024						
AKTIVET						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre		2,096,063,998	-	-	2,096,063,998	2,096,063,998
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale		68,253,878,520	-	-	68,253,878,520	60,750,458,984
TOTALI		70,349,942,518	-	-	70,349,942,518	62,846,522,982

DETYRIMET

Detyrime të tjera

TOTALI

	-	-	-	16,580,902	16,580,902	16,580,902
TOTALI	-	-	-	16,580,902	16,580,902	16,580,902

	Investime të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj)	Investime të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj)	Investime të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH)	Të tjera me koston e amortizuar	Vlera kontabël neto	Vlera e drejtë
Më 31 dhjetor 2023						
AKTIVET						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre		1,404,953,188	-	-	1,404,953,188	1,404,953,188
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale		62,318,880,652	-	-	62,318,880,652	62,244,620,459
TOTALI		63,723,833,840	-	-	63,723,833,840	63,649,573,647

DETYRIMET

Detyrime të tjera

TOTALI

	-	-	-	13,923,794	13,923,794	13,923,794
TOTALI	-	-	-	13,923,794	13,923,794	13,923,794

Për shkak të afatit të shkurtër të maturimit, Drejtimi vlerëson se vlerat e drejta të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, dhe detyrimet e tjera janë të njëjta me vlerat kontabël neto më 31 dhjetor 2024 dhe 2023. Drejtimi vlerëson vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale në letra me vlerë, duke përdorur normat e verifikueshme të tregut (kategoria 2) për letra me vlerë të ngjashme me afat të ngjashëm maturimi, bazuar në afatin e mbetur për të mbledhur flukse kontraktuale më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

8. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë detajuar si më poshtë:

Gjendjet në banka	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Depozitat afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë (7 ditore)	2,059,010,000	1,383,990,000
Llogaritë rrjedhëse në Bankën e Shqipërisë	1,433,487	4,793,221
Llogaritë rrjedhëse në Raiffeisen Bank	1,269,789	4,150,454
Llogaritë rrjedhëse në Intesa San Paolo	1,401,443	5,697,646
Llogaritë rrjedhëse në Raiffeisen Bank International	36,073,699	2,761,008
Llogaritë rrjedhëse në BKT	549,105	3,249,081
Llogaritë rrjedhëse në Credins	308,331	311,932
Zbritur provigjoni për llogaritë bankare ne monedhe të huaj	(3,981,856)	(154)
TOTALI	2,096,063,998	1,404,953,188

Rregullorja "Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave", e miratuar në 28 korrik 2016, e ndryshuar, kërkon që transhi i likuiditetit në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 10% e totalit të mjeteve financiare. Ky transh përfshin gjendjen në llogaritë rrjedhëse, depozitat, si dhe titujt me maturitet të mbetur nga 0 - 3 muaj (shih dhe shënimin 9). Depozitat e afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë vendosen në zbatim të VKM nr.39 të BSH datë 18.07.2007, me maturitet 7 ditore dhe normë kthimi 10bp më pak se norma bazë e interesit.

Agjencia vlerëson rrezikun e kredisë për llogaritë bankare në monedhë të huaj dhe ka llogaritur humbjet e pritshme nga kredia sipas modelit të ndërtuar për implementimin e SNRF 9, duke përdorur probabilitetin e humbjes, ekspozimin ndaj humbjes dhe mundësitë e humbjes. Vlerësimet e institucioneve në të cilat Agjencia mban llogari bankare në lekë dhe monedhë të huaj jepen në shënimin 6.1

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, lëvizja e provigjoni të njohur për llogaritë bankare në monedhë të huaj pranë Bankës së Shqipërisë jepet në vijim:

	2024	2023
Teprica në 1 janar	154	10,835
Shpenzime provigjoni njohur gjatë vitit	(3,991,847)	-
Rimarrje provigjoni gjatë vitit	-	(10,681)
Totali i shpenzimit të provigjoni, net	(3,981,702)	154
Teprica mbyllëse më 31 dhjetor	(3,981,702)	154

9. Instrumente financiare të mbajtur për të mbledhur flukset kontraktuale

Letrat me vlerë sipas vlerës së tyre kontraktuale paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Letra me Vlerë të Qeverisë Shqiptare në vlerë nominale	62,521,782,500	58,582,126,000
Letra me Vlerë të Qeverive të Huaja në vlerë nominale	5,025,280,000	3,168,340,000
Interes i përlllogaritur	857,273,956	726,353,361
E ardhur e marrë në avancë nga BTH	(152,408,518)	(146,592,620)
Primi i obligacioneve të Qeverisë Shqiptare	15,739,996	5,396,099
Provigjon për Obligacionet në monedhën EUR	(13,789,414)	(16,742,188)
TOTALI	68,253,878,520	62,318,880,652

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

9. Instrumente financiare të mbajtur për të mbledhur flukset kontraktuale (vazhdim)

9.1 Letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare

Investime në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Klasifikimi sipas monedhës		
Letra me Vlerë në LEK	59,238,457,694	54,010,554,151
Letra me Vlerë në EUR	9,015,420,826	8,308,326,501
TOTALI	68,253,878,520	62,318,880,652

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Klasifikimi sipas S&P		
Qeveria e Shqipërisë B+	68,253,878,520	62,318,880,652
TOTALI	68,253,878,520	62,318,880,652

Instrumente financiare sipas afatit kontraktual të maturimit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	Norma mesatare e ponderuar	31 dhjetor 2023	Norma mesatare e ponderuar
LVL në LEK				
12 muaj	10,592,540,000	3.15%	9,193,200,000	3.52%
24 muaj	24,883,200,000	4.27%	25,877,200,000	3.13%
3 vjet	400,000,000	4.30%	100,000,000	4.08%
5 vjet	600,000,000	4.39%	400,000,000	3.31%
7 vjet	12,030,100,000	5.11%	10,130,100,000	3.52%
10 vjet	9,000,000,000	6.13%	7,200,000,000	4.92%
15 vjet	996,700,000	6.38%	596,700,000	4.48%
TOTALI	58,502,540,000		53,497,200,000	
LVL në EURO				
12 muaj	1,472,250,000	0.96%		
24 muaj	2,326,155,000	0.53%	3,999,380,000	2.20%
3 vjet	981,500,000	1.72%		
5 vjet	1,889,387,500	3.50%	207,760,000	3.50%
7 vjet	1,619,475,000	3.50%	3,246,250,000	3.50%
10 vjet	755,755,000	3.50%	799,876,000	3.50%
TOTALI	9,044,522,500		8,253,266,000	

Agjencia vlerëson rrezikun e kredisë dhe humbjet e pritshme duke përdorur probabilitetin e humbjes, ekspozimin ndaj humbjes dhe mundësinë e humbjes. Drejtimi i Agjencisë vlerëson konsideron analiza historike si edhe informacion për të ardhmen për të vlerësuar ndonjë humbje të pritshme. Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, të gjitha letrat me vlerë që Agjencia zotëron janë të Qeverisë Shqiptare. Drejtimi i Agjencisë vlerëson që për letrat me vlerë në LEK të Qeverisë Shqiptare rreziku kreditor është pothuajse zero, prandaj nuk është njohur asnjë provigjon për këto letra me vlerë.

Agjencia ka njohur provigjon vetëm për aktivet financiare në monedhën EUR, duke konsideruar rrezikun e monedhës, megjithëse vlerëson që Qeverisë Shqiptare nuk paraqet rrezik të shtuar krediti edhe për këto letra me vlerë.

	2024	2023
Teprica në 1 janar	16,742,342	18,699,065
Shpenzime provigjoni njohur gjatë vitit	-	(1,956,723)
Rimarje provigjoni gjatë vitit si rezultat i maturimit të LV	2,952,774	-
Teprica mbyllëse më 31 dhjetor	13,789,568	16,742,342

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare
(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

10. Aktivet afatgjata materiale, neto

	Ndërtesa	Instalime teknike	Pajisje kompiuterike	Automjete	Pajisje zyre	Totali
Më 1 janar 2023	75,964,389	14,657,169	31,573,532	9,887,136	13,316,003	145,398,229
Shtesa	64,800	282,000	1,056,030		151,184	1,554,014
Më 31 dhjetor 2023	76,029,189	14,939,169	32,629,562	9,887,136	13,467,187	146,952,243
Shtesa	1,101,200	45,600	8,431,104	-	135,000	9,712,904
Më 31 dhjetor 2024	77,130,389	14,984,769	41,060,666	9,887,136	13,602,187	156,665,147
Amortizimi i akumuluar						
Më 1 janar 2023	(35,342,035)	(8,862,650)	(18,105,682)	(7,607,676)	(12,031,351)	(81,949,394)
Amortizimi i periudhës	(1,961,753)	(1,190,833)	(3,174,785)	(911,784)	(355,709)	(7,594,864)
Më 31 dhjetor 2023	(37,303,788)	(10,053,483)	(21,280,467)	(8,519,460)	(12,387,060)	(89,544,258)
Amortizimi i periudhës	(1,975,162)	(1,244,965)	(3,883,515)	(911,784)	(269,690)	(8,285,116)
Më 31 dhjetor 2024	(39,278,950)	(11,298,448)	(25,163,982)	(9,431,244)	(12,656,750)	(97,829,374)
Vlera kontabël neto						
Më 31 dhjetor 2022	40,622,354	5,794,519	13,467,850	2,279,460	1,284,652	63,448,835
Më 31 dhjetor 2023	38,725,401	4,885,686	11,349,095	1,367,676	1,080,127	57,407,985
Më 31 dhjetor 2024	37,851,439	3,686,321	15,896,684	455,892	945,437	58,835,773

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, Agjencia nuk ka asnjë aktiv material afatgjatë të vendosur si kolateral.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

11. Aktivet afatgjata jo materiale, neto

	Programe kompjuterike	Totali
Kosto		
Më 1 janar 2023	80,176,802	80,176,802
Shtesa	2,562,000	2,562,000
Më 31 dhjetor 2023	82,738,802	82,738,802
Shtesa	-	-
Më 31 dhjetor 2024	82,738,802	82,738,802
Amortizimi i akumuluar		
Më 1 janar 2023	(80,176,702)	(80,176,702)
Më 31 dhjetor 2024	(80,176,702)	(80,176,702)
Amortizimi i vitit	(534,875)	(534,875)
Më 31 dhjetor 2024	(80,711,576)	(80,711,576)
Vlera kontabël neto		
Më 31 dhjetor 2022	100	100
Më 31 dhjetor 2023	2,562,100	2,562,100
Më 31 dhjetor 2024	2,027,125	2,027,125

12. Aktive të tjera, neto

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Inventari	1,944,081	2,057,771
Shpenzime të parapaguara	960,622	638,326
Aktive të tjera	1,522,460	3,126,319
TOTALI	4,427,163	5,822,416

Zëri aktive të tjera përbëhet nga vlera prej 3,727,929 lekë që lidhet me rimbursimin e kostove direkte dhe indirekte nga administrimi i Fondit të Ndërhjës së Jashtëzakonshme (shënimin 18), si edhe nga shuma 2,394 të arkëtueshme nga punonjësit e Agjencisë. Gjithashtu, për vitin 2024 Agjencia ka provigjonuar shumën 2,478,363 për provigjone për çështje gjyqësore në lidhje me stafin dhe veprimtarinë e saj. (shënimin 24).

13. Detyrime të tjera

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzime të përlogaritura	3,270,020	6,218,598
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,224,640	1,056,151
Tatimi mbi të ardhurat personale	1,767,440	1,673,840
Detyrime të tjera	10,318,802	4,975,205
TOTALI	16,580,902	13,923,794

Shpenzime të përlogaritura lidhen me fatura të pa mbërritura për vitin 2024 për detyrimet lidhur me blerjen e pajisjeve kompjuterike, me shërbimin e auditimit të jashtëm dhe auditimit të brendshëm, si edhe detyrimet për fatura të pa mbërritura (detyrime mujore operative).

Detyrime të tjera lidhet me fatura të mbërritura, por të papaguara deri më 31 dhjetor 2024 për mirëmbajtjen e infrastrukturës, pajisjes së informacionit, etj., të cilat janë paguar në fillim të vitit 2025.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç së kur shprehet ndryshe)

14. Fondet themeltare

Më 31 dhjetor 2024, Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka prej 400,000,000 Lek (31 dhjetor 2023: 400,000,000 Lek) dhe Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK prej 76,000,000 Lek (31 dhjetor 2023: 76,000,000 Lek) përfaqësojnë kontributet e Buxhetit të Shtetit për fondet e sigurimit të depozitave në banka dhe SHKK. Sipas ligjit "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, Fondet themeltare mund të përdoren për përgatitjen dhe financimin e kompensimit të depozitave. Me kërkesë të Agjencisë dhe me miratim të Qeverisë Shqiptare, Fondet themeltare mund të rriten nga kontribute shtesë të Buxhetit të Shtetit.

15. Të ardhura nga primet e sigurimit

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024, të ardhurat e Agjencisë nga primet e sigurimit të arkëtuara nga 11 banka dhe 9 shoqëri kursim-krediti ishin në shumën 4,422,317,060 Lek (2023: 4,193,699,571 Lek). Në mbyllje të vitit 2024, anëtare të skemës së sigurimit të depozitave janë 11 banka dhe 9 shoqëri kursim krediti.

Në përputhje me ligjin për sigurimin e depozitave, primi i sigurimit të depozitave përlllogaritet nga subjektet anëtare në baza tremujore. Për bankat primi tremujor i sigurimit përlllogaritet si 0.125% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në bankë në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Për shoqëritë e kursim-krediti primi tremujor i sigurimit përlllogaritet si 0.075% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në këto shoqëri në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm.

16. Të ardhura nga kontributi fillestar

Çdo subjekt, i cili kërkon të anëtarësohet në skemën e sigurimit të depozitave, paguan kontribut fillestar në masën 0,5 për qind të kapitalit fillestar të tij, të konvertuar në lekë, për të marrë vërtetimin për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave. Ky subjekt paguan në fund të vitit të parë të anëtarësimit në skemë shtesën e kontributit fillestar, që përlllogaritet në masën 0,5 për qind të kapitalit të shtuar gjatë atij viti. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 të ardhurat nga kontributi fillestar janë 0 lek.

17. Të ardhurat nga interesat

Të ardhurat nga interesat për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë krijuar nga aktivitetet e mëposhtme:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare në LEK	2,509,356,025	2,080,401,312
Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe të huaja në EUR	233,625,560	183,009,189
Depozita afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë	99,160,811	90,857,757
Të ardhura të tjera nga interesat	1,525,806	830,225
TOTALI	2,843,668,202	2,355,098,483

18. Të ardhurat të tjera operative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga administrimi të tjera	3,151,927	2,527,926
TOTALI	3,151,927	2,527,926

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

18. Të ardhurat të tjera operative (vazhdim)

Të ardhura të tjera përfshijnë shumën që Agjencia do të kompensojë nga Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për administrimin e tij në vlerë 3,151,927 lekë.

Në zbatim të nenit 16, të Rregullores "Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe Procedurat për Administrimin e tij" miratuar me VKM nr. 56 datë 03.10.2017, Agjencia merr një pagesë vjetore për rimbursimin e kostove për administrimin e mjeteve financiare të FNJ. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vendos për masën e rimbursimit të kostove mbështetur në relacionin e detajuar që Agjencia dërgon për shpenzimet vjetore të kryera për administrimin e FNJ.

19. Shpenzime të tjera financiare

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Komisione për linjën e kredisë	-	48,109,195
Shpenzime të tjera financiare	6,566,126	5,220,981
TOTALI	6,566,126	53,330,176

Më 11 qershor 2021, Agjencia nënshkroi një marrëveshje kredie me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), e garantuar nga Qeveria Shqiptare, për një linjë kredie në shumën 100,000,000 EUR. Sipas kushteve të kontratës, disbursimet nuk mund të ishin më të vogla se 5,000,000 EUR, ndërsa norma e interesit për pjesën e përdorur të kredisë ishte e ndryshueshme, e përcaktuar bazuar në normat e tregut në momentin e disbursimit. Kredia ishte e strukturuar për t'u paguar në dy këste vjetore, me këstin e parë të planifikuar për 30 maj 2022 dhe këstin e fundit jo më vonë se 30 nëntor 2028.

Kjo linjë kredie është mbyllur gjatë vitit 2023. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2024, Agjencia nuk ka njohur shpenzime komisioni në lidhje me të.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

20. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Shpenzimet për paga dhe shpërblime	80,964,114	76,903,323
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	8,502,994	7,876,601
Të tjera	171,686	365,389
TOTALI	89,638,794	85,145,313

Shpenzime personeli të tjera përfshijnë ndihmat ekonomike të dhëna për punonjësit e Agjencisë, shpenzime për udhëtime dhe dieta brenda vendit si edhe sigurimin vjetor të jetës dhe shëndetit për punonjësit e Agjencisë. Kategoritë e punonjësve të Agjencisë për vitin 2024 dhe 2023 jepen në tabelën në vijim:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Nivel i lartë i drejtimit	1	1
Nivel i ulët i drejtimit –klasa II.1	2	2
Nivel i ulët i drejtimit – klasa II.2	7	7
Niveli i shërbimit profesional-klasa III	7	7
Niveli i shërbimit profesional-klasa IV	8	7
Niveli i shërbimit të përgjithshëm	2	2
TOTALI	27	26

Numri mesatar i punonjësve të Agjencisë për vitin 2024 është 27 (2023: 26).

21. Shpenzimet administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Mirëmbajtje dhe riparime	3,479,943	5,499,092
Honorare të Këshillit Drejtues	5,388,777	5,568,403
Shpenzime të tjera operative	4,764,902	3,845,276
Tarifa anëtarësimi (EFDI, IADI)	1,849,128	2,497,925
Shërbime profesionale	2,628,000	2,664,000
Shërbime utilitare	1,922,848	1,717,128
Shpenzime postare dhe komunikimi	714,358	703,478
Shpenzime për pajisje zyre	247,529	194,301
Trajnime dhe edukime të vazhdueshme	2,399,342	5,071,980
Publikime dhe abonime	1,321,863	1,936,153
Seminare dhe konferenca	234,135	128,094
Tarifat dhe taksat vendore	15,000	15,000
Provizione për kreditorë të tjerë	2,207,859	-
TOTALI	27,173,684	29,840,830

Shpenzime të tjera operative lidhen me shpenzimet për pritje përcjellje dhe organizime, shpenzime për sigurimin e aktiveve të Agjencisë dhe ruajtjen e sigurisë fizike, shpenzime për karburant për automjetin e Agjencisë dhe shpenzime pastrimi.

Shërbime profesionale përfshijnë shpenzimet për shërbime konsulence financiare.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

22. Të ardhurat gjithëpërfshirëse të fondeve të sigurimit të depozitave

Bazuar në ligjin për sigurimin e depozitave, Agjencia mban llogari të veçanta kontabël për mjetet financiare, për depozitat e siguruara në bankat dhe mjetet financiare për sigurimin e depozitave në SHKK-të. Fondet e akumuluar për secilin fond zmadhohen ose zvogëlohen me fitimet apo humbjet nga veprimtaria e Agjencisë.

	31 dhjetor 2024		
	Fondi i sigurimit të depozitave në		
	Banka	SHKK	Total
Të ardhura operative:			
Të ardhura nga primet e sigurimit	4,398,825,789	23,491,271	4,422,317,060
Të ardhura nga veprimtaria investuese	2,832,739,715	10,928,487	2,843,668,202
Të ardhura të tjera operative	3,151,927	-	3,151,927
Shpenzime financiare:			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj	(512,960,331)	-	(512,960,331)
Shpenzime të tjera financiare	(6,316,126)	(250,000.00)	(6,566,126)
Shpenzime operative:			
Shpenzime personeli	(89,638,794)	-	(89,638,794)
Shpenzime administrative	((27,041,706.)	(131,977)	(27,209,682)
Shpenzime amortizimi	(8,819,992)	-	(8,819,992)
Shpenzime provigjioni për mjetet monetare	(3,991,848)	-	(3,991,848)
Rimarrje provigjioni për aktivet financiare	2,962,918	-	2,962,918
TEJKALIMI I TË ARDHURAVE NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN	6,588,911,552	34,037,780	6,622,949,333
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6,588,911,552	34,037,780	6,622,949,333

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

22. Të ardhurat gjithëpërfshirëse të fondeve të sigurimit të depozitave (vazhdim)

	31 dhjetor 2023		
	Fondi i sigurimit të depozitave në		
	Banka	SHKK	Total
Të ardhura operative:			
Të ardhura nga primet e sigurimit	4,171,583,296	22,116,275	4,193,699,571
Të ardhura nga veprimtaria investuese	2,346,171,598	8,926,885	2,355,098,483
Të ardhura të tjera operative	2,527,926	-	2,527,926
	6,520,282,820	31,043,160	6,551,325,980
Shpenzime financiare:			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj	(659,334,197)	-	(659,334,197)
Shpenzime të tjera financiare	(53,080,176)	(250,000)	(53,330,176)
	(712,414,373)	(250,000)	(712,664,373)
Shpenzime operative:			
Shpenzime personeli	(85,145,313)	-	(85,145,313)
Shpenzime administrative	(29,513,283)	(327,549)	(29,840,832)
Shpenzime amortizimi	(7,594,865)	-	(7,594,865)
Shpenzime provigjioni për mjetet monetare	(112)	-	(112)
	(122,253,573)	(327,548)	(122,581,122)
Rimarrje provigjioni për aktivet financiare	1,967,672	-	1,967,670
TEJKALIMI I TË ARDHURAVE			
NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN	5,687,582,546	30,465,611	5,718,048,157
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE			
GJITHËPËRFSHIRËSE	5,687,582,546	30,465,611	5,718,048,157

23. Marrëdhëniet dhe transaksionet me institucionet, organet dhe ndërmarrjet shtetërore

Agjencia konsideron palët e lidhura, detajuar si më poshtë:

- *Institucionet shtetërore me të cilat Agjencia ka marrëdhënie në bazë të statusit dhe funksioneve të saj ligjore;*
- *Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, dhe drejtues të tjerë kryesorë të përcaktuar si persona që kanë autoritet dhe përgjegjësi për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë së Agjencisë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke përfshirë çdo drejtues (qoftë ekzekutiv ose ndryshe) të Agjencisë.*

Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave janë institucionet shtetërore, me të cilat Agjencia ka ndërtuar marrëdhënie të rregullta në bazë të statusit dhe funksioneve të saj ligjore dhe në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse (shih dhe Shënimin 6).

Agjencia drejtohet nga Këshilli Drejtues, anëtarët e të cilit emërohen në përputhje me ligjin "Për sigurimin e depozitave" të ndryshuar (Shënimi 2).

Një pjesë e rëndësishme e aktiveve financiare janë investuar në instrumente borxhi të emetuara nga Qeveria Shqiptare ose vendosur në depozita afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë (Shënimet 8 dhe 9). Investimet në letra me vlerë blihen si në tregun primar përmes pjesëmarrjes në ankande, ashtu edhe në tregun dytësor.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

23. Marrëdhëniet dhe transaksionet me institucionet, organet dhe ndërmarrjet shtetërore (vazhdim)

Transaksionet e veprimeve me palët e lidhura jepen si në vijim:

Pasqyra e Pozicionit Financiar	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktivët		
Investime në letra me vlerë		
të Qeverisë Shqiptare (shënimi 9.1)	68,253,878,520	62,318,880,652
Llogaritë rrjedhëse në		
Bankën e Shqipërisë (shënimi 8)	1,433,487	4,793,221
Depozitat afatshkurtra në		
Bankën e Shqipërisë (shënimi 8)	2,059,010,000	1,383,990,000
Aktive të tjera	3,727,929	3,103,929
TOTALI	70,318,049,936	63,710,767,802

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të ardhura nga letrat me vlerë		
të Qeverisë Shqiptare (shënimi 18)	2,706,721,037	2,246,338,522
Të ardhura nga depozitat afatshkurtra		
në Bankën e Shqipërisë (shënimi 18)	99,160,811	90,857,757
Të ardhura të tjera nga FNJ (shënimi 18)	3,151,927	2,527,926
Honorarë për Këshillin Drejtues	(5,388,777)	(5,568,403)
Shpenzime për komisione		
për llogaritë e titujve në BSH	(750,000)	(750,000)
TOTALI	2,802,894,998	2,333,405,802

24. Çështjet ligjore

Gjatë rrjedhës normale të aktivitetit, Agjencia mund të jetë e përfshirë në pretendime ligjore ose veprime ndaj palëve të treta. Agjencia me vendimin nr. 3803 datë 06 tetor 2017 të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë, gëzon të drejtën e dëmshpërblimit nga Shoqëria Pacific-Petroleum Albania sh.p.k për shumën 270,504 lekë, detyrim që nuk është shlyer gjatë këtyre viteve. Agjencia ka provigjonuar shumën e pritshme në vitin 2018 pasi vlerëson që mundësia për ekzekutimin e detyrimit nga Agjencia e paditur, është e vogël. Në bazë të mendimit të Drejtimit të Agjencisë, përfundimi final në lidhje me çështjet ligjore nuk do të ketë një efekt mbi pozicionin financiar të Agjencisë, ose nuk do të sjellë ndryshime në aktive. Agjencia gjatë vitit 2024 ka marrë njoftim për Vendimi nr. 994, datë 21.02.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm ka caktuar detyrimin e Agjencisë së paditur për të dëmshpërblyer ish punonjësen e saj në vlerë 2,207,859 lekë. Në rast se Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë do të lërë në fuqi Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Agjencia do të paraqesë në Gjykatën e Lartë një rekurs si dhe një kërkesë për pezullim ekzekutimi të vendimit të Gjykatës së Apelit. Në bazë të mendimit të Drejtimit të Agjencisë, përfundimi final në lidhje me çështjet ligjore nuk do të ketë një efekt mbi pozicionin financiar të Agjencisë, ose nuk do të sjellë ndryshime në aktive.

25. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të ndodhura pas datës së raportimit financiar që mund të kërkojnë rregullim apo shpalosje të tjera kontabël në këto pasqyra financiare.